


01-479



Në bazë të nenit 21, 22, 44 dhe 79 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 17 pika “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt. 20.02.2008, dhe nenit 15 pika “d” të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110-391, dt.25.02.2010, Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 06/2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi, për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr.350/02-39459/24 dt.20.03.2024, të aplikuesit/pronarit **Ramadan Makolli** nga Prishtina, me investitor:“**Al Trade Center**” sh.p.k., Rr.Jasharajeva, p.n.Glllogoc, me certifikatë të regjistrimit të biznesit nr. 811167924, dhe me pronar Sokol Gashani nga Tërsteniku/Komuna e Glllogocit për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë së aktit administrativ “**Vendim për caktimin e Kushteve Ndërtimore**”, me referencë 05 NR. 350/02-40542/22 DT. 05.04.2023, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datë 17.05.2024, merr këtë:

V E N D I M

PËR VAZHDIMIN E AFATIT TË VLEFSHMËRISË SË AKTIT ADMINISTRATIV “VENDIM PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE” 05 NR. 350/02-40542/22 DT. 05.04.2023

I. I VAZHDOHET afati i vlefshmërisë aktit administrativ “**Vendim për caktimin e Kushteve Ndërtimore**”, me referencë 05 NR. 350/02-40542/22 DT. 05.04.2023, i lëshuar nga kjo drejtori, në emër të aplikuesit/pronarit **Ramadan Makolli** nga Prishtina, me investitor:“**Al Trade Center**” sh.p.k., Rr.Jasharajeva, p.n.Glllogoc, me certifikatë të regjistrimit të biznesit nr. 811167924, dhe me pronar Sokol Gashani nga Tërsteniku/Komuna e Glllogocit, në kuadër të parcelës ndërtimore “E-7-4” të bllokut urban “E-7”, të tërësisë “E”, të Planit Rregullues “Prishtina e Re-Zona Perëndim”, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr.10171-1 ZK.Prishtinë.

II. Afati i vlefshmërisë së aktit administrativ nga paragrafi I. i këtij vendimi, vazhdohet edhe për një (1) vit tjetër, dhe i njëjti do të prodhojë efekte juridike nga dita e njoftimit të palës me këtë akt.

A r s y e t i m

Aplikuesi/pronari **Ramadan Makolli** nga Prishtina, me investitor:“**Al Trade Center**” sh.p.k., me seli në Glllogoc, me certifikatë të regjistrimit të biznesit nr. 811167924, dhe me pronar Sokol Gashani nga Tërsteniku/Komuna e Glllogocit, me kërkesën 05 Nr.350/02-39459/24 dt.20.03.2024, ka kërkuar nga Drejtoria e Urbanizmit, vazhdimin e afatit të vlefshmërisë së aktit administrativ “**Vendim për caktimin e Kushteve Ndërtimore**”, me referencë 05 NR. 350/02-40542/22 DT. 05.04.2023. Me kërkesën 05 Nr.350/02-39459/24 dt.20.03.2024, është prezantuar Vendimi i Kushteve Ndërtimore 05 NR. 350/02-40542/22 DT. 05.04.2023, lëshuar nga kjo drejtori;

Drejtoria e Urbanizmit, pas pranimit të kërkesës për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë së aktit administrativ “**Vendim për lejimin e ndërtimit të kompleksit me ndërtesa shumëbanesore afariste**”, me referencë 05 NR. 350/02-40542/22 DT. 05.04.2023, shqyrtimit të përmbajtjes së saj dhe konsultimit të rregullativës ligjore në fuqi, dhe të dosjes së lëndës/kërkesës 05 Nr.350/02-40542/22 dt.24.02.2022 në arkivin e drejtorisë, në mënyrë procedurale dhe kronologjike konstatoi si në vijim:

- Drejtoria e Urbanizmit, me aktin administrativ “**Vendim për caktimin e Kushteve Ndërtimore**”, me referencë 05 NR. 350/02-40542/22 DT. 05.04.2023, i ka lejuar aplikuesit/pronarit **Ramadan Makolli** me investitor:“**Al Trade Center**” sh.p.k., me seli në Glllogoc, ndërtimin e kompleksit me ndërtesa shumëbanesore afariste, në kuadër të parcelës ndërtimore “E-7-4” të bllokut urban “E-7”, të tërësisë “E”, të Planit Rregullues “Prishtina e Re-Zona Perëndim”, konkretisht në kuadër të parcelës

Faqe 1 prej 2

kadastrale nr.10171-1 ZK.Prishtinë”, konform dispozitive ligjore të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim, të Udhëzimit Administrativ të MMPH-së nr. 06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve.

- Sipas paragrafit të parë të pikës “XV”, të aktit administrativ “Vendim për caktimin e Kushteve Ndërtimore”, me referencë 05 NR. 350/02-40542/22 DT. 05.04.2023, thuhet se poseduesi i lejes ndërtimore është i obliguar që, citoj: *“Vlefshmëria e vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore është një (1) vit, me mundësi të vazhdimit për një (1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor, dhe me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë”*, kërkesa për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë është parashtruar me datë 20.03.2024, ndërsa data e tërheqjes së Vendimit të kushteve ndërtimore nga DU është bërë me 05.04.2024, gjë e cila është në harmoni me afatin dhe pikën 8 të nenit 13 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 06/2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi, për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, ku thuhet se, citojmë: *“Kushtet ndërtimore të miratuara nga organi kompetent apo nga veprimi i ligjit, parimi heshitja është pranimit do të jenë të vlefshme për një(1) vit, me mundësi vazhdimi për një (1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor”*.

- Bazuar në dosjen e lëndës/kërkesës 05 Nr.350/02-39459/24 dt.20.03.2024, për caktimin e kushteve të ndërtimit, konstatohet se akti administrativ “Vendimi për caktimin e Kushteve Ndërtimore”, me referencë 05 NR. 350/02-40542/22 DT. 05.04.2023, ka filluar prodhimin e pasojës juridike nga data e njoftimit të aplikuesit/pronarit me aktin administrativ, e që është data 05.04.2023, kurse kërkesa për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë është parashtruar me datë 20.03.2024, gjë e cila është në harmoni me afatin, rrethanat dhe pikën 8 të nenit 13 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 06/2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi, për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, ku thuhet se, citojmë: *“Kushtet ndërtimore të miratuara nga organi kompetent apo nga veprimi i ligjit, parimi heshitja është pranimit do të jenë të vlefshme për një(1) vit, me mundësi vazhdimi për një (1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor”*;

Andaj, bazuar në konstatimet e lartshënuara, dhe në rregullativën ligjore në fuqi, u konstatua se vazhdimi i afatit të vlefshmërisë së aktit administrativ për lejimin e ndërtimit, është i bazuar dhe ligjor, dhe kjo drejtori të njëjtit vendosi t’ia vazhdojë afatin e vlefshmërisë edhe për një (1) vit tjetër përmes këtij vendimi.

Bazuar në dispozitat ligjore të përmendura, ky organ vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij Vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror-MMPHI.

Ky vendim u printua në 5 (pesë) kopje identike dhe i dërgohet: Kërkuesit/Investitorit, Qendrës për shërbim me qytetarë, kësaj drejtorie dhe në dosje të lëndës 05 Nr.350/02-39459/24 dt.20.03.2024 dhe 05 Nr.350/02-40542/22 dt.24.02.2022.

Kopja elektronike i dërgohet: Drejtorisë së Pronës, Drejtorisë së Kadastrit dhe Drejtorisë së Planifikimit Strategjik.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 350/02-39459/24 DT. 17.05.2024**

Zyrtari,
Anisa Osmari


Udhëheqëse e Sektorit,
Nazifë Krasniqi
